



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr. 1198 Akti
Datë 12.05.2016

Nr. 1081 Vendimi
Datë 24.06.2016

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 24.06.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr. 1198 Akti, që u përket palëve:

PADITËS:Shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K me nr-K88128801D NUIS, me seli ne lagjen "28 Nentori", Ballsh Mallakaster me administrator Ermir Shametaj, përfaqësuar ne gjykim me autorizim nga Dervish Alimerkaj identifikuar nga gjykata me kartën e identitetit me nr-G40301184D i cili ka zgjedhur me deklaram ne seance gjyqësore për te përfaqësuar shoqërinë av.Kujtim Cakrani me nr. 8315 license dhe me nr-L67526801C NUIS (ne mungese ne shpalljen vendimit).

I PADITUR:1-Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tirane, përfaqësuar ne gjykim me autorizimin nr.17542/1 prot date 31.05.2016 nga Ervisa Shabani.

2-Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuar ne gjykim me autorizimin nr.10908/1 prot date 26.05.2016 nga Ervisa Shabani.

Me pjesëmarrjen ne gjykim te Avokatures se Shtetit Zyra Vendore Vlorë(ne mungese).

OBJEKTI:1 - Shfuqizimin e aktit administrativ Proces-verbal Gjobe me Nr.serie:0194752 te date 06.11.2015 te Drejtorise Tatimore te Rajonit Jugor (Fier) dhe te Vendimit Nr.6989/1 date 21.04.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor per denimin me 30,000 leke gjobe.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 11, 15/a , 16, 17/1/a, 18/1,40/1, a i ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative" dhe nenet 154, 156, 324, 328 te K.Pr.C, Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë";

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të ndodhura në dosje, pala paditëse shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K, nuk u degjua ne pretendimet perfundimtare pasi ishte ne mungese, dëgjoi palën e paditur Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tirane si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuesen e Ervisa Shabani e cila kërkoi nga gjykata rrëzimi e kërkesë padisë, pala pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk rezulton të ketë paraqitur prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykata ne lidhje me këtë gjykim, pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë dijeninë e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Se pala paditëse shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me një kërkesë padi me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze te nenit 12 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", gjykimi u zhvillua me trup gjykues te përberë nga një gjyqtar. Gjykata kryesisht bazuar ne nenin 125 dhe 193 te K.Pr.Civile vendosi thirrjen ne gjykim te perfaqesueses se interesave te shtetit Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore.

Rrethanat e faktit:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësi shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K ushtron aktivitet tregtar me veprimtari "*transport mallrash dhe udhëtarësh etj*" me seli ne qytetin e Ballshit, e regjistruar ne Qendren Kombëtare te Regjistrimit me nr-K88128801D NUIS fakt i cili rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar.

Rezulton se ne date 06.11.2015 nga ana e inspektoreve te Drejtorisë se Hetimit Tatimor është ushtruar kontroll ne automjetin me targe AA350JC qe përdoret nga pala paditëse shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K, ku ne përfundim është mbajtur akt konstatimi me nr.0529533 date 06.11.2015 ku ne mjetin e kontrolluar janë gjetur 10 udhëtar te pajisur me bileta qe ishin prere për çmimin 160 leke ndërkohë qe sipas deklaratave te tyre ata kishin paguar nga 250 leke.

Ne vijim nga ana e inspektoreve është mbajtur proces-verbali i gjobës me nr-0194752 date 06.11.2015 me anën e te cilit paditësi është sanksionuar me gjobe ne masën 30.000 leke bazuar ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë*" neni 122 pika 1 germa ç.

Referuar akt konstatimin e nr.0529533 date 06.11.2015 si dhe proces-verbal gjobe me nr-0194752 date 06.11.2015 te mbajtur nga Inspektoret e Hetimit Tatimor është vijuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier është nxjerr Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet Tatimore me nr.4060 date

22.02.2016 me anën e te cilit pala paditëse ngarkohet me detyrimin e gjobës ne vlerën 30.000 leke.

Ndaj Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet Tatimore me nr.4060 date 22.02.2016 e nxjerr nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier pala paditëse shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë se Apelit Tatimor pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane, e cila kjo e fundit me vendimin me nr.6989/1 prot date 21.04.2016 ka vendosur *"lenien ne fuqi te aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet Tatimore me nr.4060 date 22.02.2016 i nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier për gjobën ne masën 30.000 leke, bazuar ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" neni 122 pika 1 germa ç"*.

Paditësi shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K duke mos qene dakort me Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet Tatimore me nr.4060 date 22.02.2016 i lene ne fuqi me vendimin nr.6989/1 prot date 21.04.2016 nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane, i eshte drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;

Së pari: ndaj subjekti "Shametaj Transport" Shpk me seli ne Ballsh ne lagjen "28 Nentori", ne daten 06.11.2015 është mbajtur nje akt konstatimi me nr.0529533 dhe Proces-verbal Gjobe me Nr-0194752 serie te date 06.11.2015 nga ana e inspektoreve te Hetimit Tatimor Rajoni Jugor,ne mjetin me targa AA 350 JC .

Nga kontrolli i kryer nga inspektoret eshte konstatuar qe udhetaret qe udhetonin me linjen e Autobuzit Ballsh-Vlore-Ballesh,ishin pajisur me bileta udhetimi ,por me destinacion Qytetin e Fierit dhe me bileta 160 lekesh.

Nga ana e inspektoreve është kerkuar qe udhëtarët te ishin pajisur me bileta 250 lekëshe pasi ky ishte destinacioni i ketij mjeti, ku nga drejtuesi i mjetit i është shpjeguar inspektoreve se i ka pajisur udhëtarët sipas destinacionit te tyre dhe jo sipas destinacionit te mjetit.

Së dyti; Nga ana e inspektoreve ky veprim eshte quajtur kundravajtje administrative duke e gjobitur subjektin ne masen 30.000 mije leke, ku paditesi ka ushtruar te drejten e Ankimit administrativ ne Drejtorin e Apelit Tatimor, por nga pergjigja e kthyer nga ana e Apelit Tatimor Tirane ne date 21.04.2016 me nr prot 6989/1 eshte lene ne fuqi vendimi per gjobitjen ne masen 30.000 mije leke te subjekti "Shametaj Transport" Shpk.

Brenda afatit 30 dite paditesi i eshte drejtuar gjykates administrative per shfuqizimin e ketij akt administrativ ,si nje akt qe bie ne kundërshtim me ligjin.

Paditesi parashtrohet se, cmimi i biletave te Autobuzeve te linjave bazohet ne Ligjin per cmimet dhe tarifat i cili percaktohet nga Ministria e Transporteve,e cila percakton ne baze te distances se udhetimit edhe cmimin e biletës.

Duke qene se udhetaret nuk jane gjithnje deri ne destinacionin perfundimtare te linjes te percaktuar ne licencen e udhetimit, shpesh ndodhe qe udhetare jane me destination deri ne mes te udhetimit dhe konform ligjit ne fuqi dhe distances qe pershkuan udhetari paditesi i ka prere biletën me destinacionin e tij, me çmimin 160 leke.

Nga ana e inspektoreve te Hetimit Tatimor u verifikua dhe u konstatua qe te gjithë udhetaret ishin te pajisur me bileta deri ne destinacionin e tyre, por me pretendimin se ky autobuze ben linjen Vlore-Ballesh edhe pasagjeret duhet te ishin pajisur me bileta deri ne Ballesh me vler 250 lek.

Edhe kur jane pyetur udhetaret per destination e tyre te gjithë jane jane pergjigjur qe ishin per ne qytetin e Fierit dhe jo ne Ballesh, ku ne keto kushte inspektoret e hetimit talimor edhe pas konfirmimit per destinacionin e udhetimit te te gjithë udhetareve, nuk marrin asnje deklarate te vetme nga ata qe te vertetojne pretendimet e tyre por gjobisin subjektin "Shametaj Transport" Sh.P.K me gjobe ne masen 30.000 leke .

Për sa me sipër paditësi shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K kërkoj nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si te bazuar ne ligj dhe ne prova.

Palët e paditura, Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tirane si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nëpërmjet përfaqësueses se tyre Ervisa Shabani ka kerkuar rrezimin e kerkese-padise duke prapësuar ne këtë gjykim se;

Së pari; Nga administrimi i provave te ndodhura prane DRT Fier, rezulton se Subjekti "Shametaj Transport" shpk me NIPT K8812880ID, me seli ne lagjen "28 Nentori", Ballesh, Mallakaster, me object kryesor te ushtrimit te aktivitetit "Transport Udhetarësh", ku nga Inspektoret e Hetimit Tatimore Rajoni Jugor, bazuar ne Urdherin e Punes me nr.1401 prot, date 06.11.2015 kane ushtruar kontroll ne automjetin me targa AA350JC ne pronesi te subjektit "Shametaj Transport".

Kontrolli eshte ushtruar ne prezence te shoferit Dervish Alimerkaj identifikuar nga leje drejtimi, me nr. Identifikimi G403011S4D, ku nga kontrolli i ushtruar eshte mbajtur Akt Konstatimit me nr.0529533 date 06.11.2015, nepermjet se cilit eshte konstatuar se :1-Subjekti eshte i regjistruar ne organet tatimore 2- Ne momentum e kontrollit subjekti transportonte udhetar te pajisur me bileta udhetimi 3- Subjekti kryen linjen Vlore-Ballesh dhe nga konstatimi. subjekti ka prere bileta 160 leke per pasagjerei qe udhetonin per destinacionin Ballesh ku real isht pasagjeret paguanin 250 leke sipas deklarates se tyre, per kete arsye ne zbatim te ligjit "Per procedural tatimore" mbahet procesverbali i Gjokes. 4- Ne momentin e kontrollit ne pune u gjend Z.Dervish Alimerkaj i datelindjes 01.03,1964, 5.Kontrolli ukrye ne oren. 15 e 50 deri ne oren 16 e 20.6- Ky akt konstatimi mbahet per ndjekej te metejshme nga organet tatimore perkatese.

Ne reference te Akt Konstatimit nr.0529533 date 06.11.2015, eshte mbajtur Proces-Verbali i gjokes me nr.0194752 dt.06.11.2015, nepermjet te cilit paditesi "Shametaj transport" eshte gjobitur me gjobe ne vleren 30.000 leke, konform nenit n.r.122.1/e per leshimin e biletave rae vlere me te vogel nga pagesa qe pasagjeret bejne faktikisht, ndersa ne reference te Akt Konstatimit me nr.0529533 date 06.11.2015 dhe te proces-verbali te gjokes me nr-0194752 date 06.11.2015 Drejtoria Rajonale Tatimore Fier eshte nxjerre "Njoftim Vleresimi Tatimor*" me nr.4060prot date 22.02.2016, nepermjet te cilit subjekti "Shametaj transport" shpk me NIPT K8812S801D i komunikohet per pagese gjoba ne vleren 30.000 per leshimin e biletave me vlere te ndryshme nga cmimi real.

Me "Njoftim Vleresirnin Tatimor" me nr.4060prot date 22.02.2016 tatimpaguesi "Shametaj transport" shpk nuk ka qene dakort dhe per kete arsyje e ka ankinuiar prane Drejtorise se Apeimit Tatimor, e cite ne perfundim te shqyrtimit te ankimit ka Ven.dosu.ar "Lenien ne Fuqi, te aktit administrative object Ankimi, "Njoftim Vleresirnin Tatimor" me nr.4060prot date 22.02.2016 per gjobe 30.000 leke, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier.

Ky vendim i eshte komunikuar paditesit me shkresen me nr.6989/1 date 21.04.2016, ku me aktet administrative te sipercituar paditesi "Shametaj transport" shpk nuk ka qene dokorte dhe per kete arsyje i eshte drejtuar gjykates me padi me objekt: "*shfuqizimin e aktit administrative Proces-Verbal Gjobe me nr.serie 0194752 date 06.11.2015 te Drejtorise se Hetimit Tatimor Rajoni Jugor dhe te Vendimit nr.6989/1 date 21.04.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor*".

Së dyti; Kundershtime mi lidhje me kerkimet ne padine e paraqitur nga verifikimi i provave materiale te ndodliura prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vleresim nr.4060prot date 22.02.2016 i dale ne baze te Proces-Verbal te gjobes me nr.0194752serie date 06.11.2015 eshte konform legjislacionit tatimor ne fuqi dhe nuk ka shkelje ligjore per shfuqizimin e tij.

Keshtu me Kodin e Procedurave Administrative ne nenin 118, percaktohen rastet se kur Aktet Administrative jane relativisht te pavlefshem: Neni 118 "*Aktet administrative relativisht te pavlefshme*", "*1.Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme. ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershtrim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme*".

Aktet administrativ Proces-Verbal Gjobe me nr.0194752serie date 06.11.2015 dhe Njoftim Vleresimi me nr.4060 prot date 22.02.2016 si dhe Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor jane ne perputhje me legjislacionin qe ka qene ne fuqi ne momentin e konstatimit te shkeljes dhe nuk jane akte te nxjerra ne kundershtrim me ligjin.

Keshtu Njoftim Vleresimi me nr.4060prot date 22.02.2016 eshte rabajtur ne zbatim te Akt Konstatimit date 06.11.2015 te Drejtorise se Hetimit Tatimor Rajoni Jugor dhe ne perputhje me nenin nr.122/1/ç te Ligjit nr.9920 "*Per Procedural Tatimore ne Republiken e Shqiperise*" i ndryshuar, dhe te Udhezimit nr.24 dt.02.09.2008 te dale ne zbatim te tij.

Proces-Verbal Gjobe me nr.serie 0194752 date 06.11.201 si dhe Njoftim Vleresimi me nr.4060prot date 22.02.2016 jane konform neneve nr.106/107/108 e ne vijim te Kodit te Procedurave Administrative per Vlefshmerine e akteve, ne to eshte specifikuar çdo gje e konstatuar si dhe baza ligjore nepermjet se ciles subjekti eshte gjobitur.

Akt Konstatimi si dhe Proçes-Verbali i Gjobes se dates 06.11.2015 jane mbajtur ne prezence te Drejtuesit te Automjetit dhe jane pranuar dhe firmosur nga Z.Dervish Alimerkaj ku Akti Konstatimi i dates 06.11.2015 i mbajtur per subjektin "Shametaj transport" eshte shume i qarte ne konstatimin e shkeljes dhe ne te eshte specifikuar qe do te mbahet Proces-Verbal Gjobe per shkeljen e konstatuar: keshtu ne Akt Konstatimin eshte theksuar se "*Ne momentin e kontrollit subjekti transportonte 10 udhetare te pajisur me bileta udhetimi, Subjekti kryen linjen Vlore -Ballesh dhe nga konstatimi subjekti ka prere bileta 160 leke per pasagjeret ne udhetonin per*

destinacionin Ballesh ku realisht pasagjeret paguanin 250 leke sipas deklarates se tyre, per kete arsye ne zbatim te ligjit "Per procedurat tatimore " mbahet procesverbali i Gjebes ".

Së treti; Gjoba eshte vendosur ne momentin e konstatimit te shkeljes, ne perputhje me nenin nr. 13 te Ligjit "Per Kundravajtjet Administrative", keshtu ne nenin nr.13 percaktohet: Neni 13 "Menyra e marrjes si vendimit per kundervajtjen administrative"

"1.Per kundervajtjen administrative parashikohet: a-marrja e gjebes ne vend, ne rastet kur kjo parashikohet nga ligji i vecante;".

Procedure kjo e realizuar ne rastin e paditesit "Shametaj transport", Akt Konstatimi dhe Procesverbali i Gjebes te dates 06.11.2015 jane hartuar ne prani te subjektit dhe ne momentin e konstatimit te shkeljes dhe jane pranuar nga kundravajtesit e vertetuar kjo me firmosjen e te dy akteve administrative te sipercituara.

Ndersa ne nenin nr.7 te Ligjit "Per Kundravajtjet Administrative" percaktohet: Neni 7 Kompetenca per konstatimin dhe shqyrtimin e kundravajtjes; "1-. Kompetenca per konstatimin e kundervajtjes, me perjashtim te rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, pergjegjes per zbatimin e ligjit te posacem ".

Keshtu ne nenin nr.2,5 e vijues te ligjit "Per Procedurat Tatimore", percaktohet se Administrata Tatimore eshte pergjegjse per zbatimin e ketij ligji.

Keshtu DRT Fier ka vazhduar me tej me procedurat ligjore dhe ne zbatim te nenit 68 te Ligjit "Per Procedurat Tatimore", "Vleresimi tatimor", inspektoret e Vleresimit prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier kane nxjerre Njoftim Vleresirnin per Detyri.rn.et Tatimore me nr.4060 prot date 22.02.2016, gjithashtu ProcesVerbali i gjebes i date 06.11.2015 dhe Njoftim Vleresimi me nr.4060 prot date 22.02.2016 te mbajtur per subjektin "Shametaj transport", jane ne perputhje edhe me nenin 6 te Ligjit "Per Kundravajtjet Administrative", keshtu ne nenin nr.6 pika a percaktohet se shklejet percaktohen me ligj.

Keshtu mos pasqyrimi i cmimit real te biletave perben shkelje konform nenit 122 te ligjit "Per Procedurat Tatimore" ne te cilin percaktohet: Neni 122 Kundervajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale, per leshimin e kuponave fiskale e te biletave "1.Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se;ç- leshon kupon tatimor, ku ka shenuar nje vlere te ndryshme nga vlera e cmimit te afishuar, me gjobe ne masen 30 000 (tridhjetë mijë) leke;.

Ndersa ne nenin nr.46 te ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore" si dhe po ne te njejtin nen te UMF nr.24 dt.02.09.2008, percaktohet:"46.1.6 Deftesa tatimore leshohet nga te gjithë personat e tatueshem shites me pakice, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, te cilet nuk jane te pajisur me arke regjistruese ose qe, sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.781 date 14.11.2007, ne raste te vecanta mund te mos leshojne kupon tatimor. Rolin e defteses tatimore mund ta luajne edhe dokumente te tjera te miratuara ne akte te tjera ligjore apo nenligjore ne fuqi, siper shembull biletat e transportit urban, inteurban apo nderkombetar te udhetareve, kuponet e leshuar nga makinal elektronike te fatit, biletat e lojerave te fatit te miratuara nga Mmistria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, etj. ".

Ne rastin konkret jemi perpara faktit qe kuponin tatimor e zevendesojn bileta dhe per kete arsye kur cmimi i biletës është e ndryshme nga vlera e cmimit te real te paguar nga pasagjeret ,kundravajtësi penalizohet me gjobe ne vleren 30.000 leke.

Së katërti; penalizimi është bere ne perputhje me klauzolat e ligjit "Per Kundrvajtjet Administrative" neni 14, ku percaktohet: Neni 14 "Menyra e mbajtjes se procesverbalit apo e nje dokumenti tjeter ti barasvlefshem me te" 1. Procesverhali i permendur ne shkronjen "b" ie pikes 1 te nenit 13 te ketij ligji rmbahet ne vendin e hyerjes iii kundervajtjes dhe ne kohen e konstatimit te saj, si rregullt, ne prani te kundervajtësit dhe te deshmitareve te pranishem dhe nenshkruhet nga perpihtesi kundervajtësi dhe deshmitaret e pranishem, ne rast se ka. Ne proces-verbal shenohen identiteti i kundervajtësit dhe lloji i kundervajtjes".

Procedure kjo e realizuar me perpikmeri ne rastin e paditesit "Shametaj Transport", pra Procesverbali i gjobes është hartuar ne prani te shoferit i identifikuar nga leja e Drejtimit te Automjetit dhe nga karta e identitetit, ne Akt Konstatimin është e specifikuar qarte lloji i kundravajtjes administrative, Akt konstatimi dhe procesverbali i gjobes jane mbajtur ne momentin e kryerjes se kundravajtjes dhe jane nenshkruar nga subjekti kundravajtjes, cka nenkupton se kundravajtësi ka pranuar shkeljen e konstatuar.

Gjithashtu edhe vendimi i Drjtorise se Apelimit Tatimor nr.6989/1 date 21.04.2016, qe ka lene ne fuqi dhe Vleresimin nr.4060 date 22.02.2016 është ne perputhje me legjislacioni tatimore është teresisht i vlefshem dhe nuk ka baze ligjore dhe shkrësore per shfuqizimin e tij.Keshtu ankimimi i subjektit "Shametaj Transport" është marre ne shqyrtim konform nenit 106 pika 1, 2 dhe3, dhe nenit 107 pika 2 te Ligjit nr.9920 "Per Procedurat Tatimore", keshtu ne ligj percaktohet: Neni 106 Objekti i ankimit administrativ tatimor" Tatim paguesi mënd ie ankimoje hinder cdo njoftim vleresimi cdo vendimi qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor, cdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor, ose cdo akti ekzekutiv te posagem tatimor, ne lidhje me tatimpaguesin. 2. Ankimi behet me shkrim dhe neformen e parashikuar ne zbatim tii ketij ligji, me udhezim te Ministrit te Financave. 3. Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne drejtorine e apeimit tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur vleresimi ose vendimi i administrates tatimore është marre ose vleresohet tejetii marre nga tatimpaguesi.

Ne keto kushte te zbatim te neneve nr.106/107/108/109 te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" dhe te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.24 date 02.09.2008 te dale ne zbatim te tij, Drejtoria e Apeimit Tatimor me vendimin per lenien ne Fuqi te Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi nr.4060 date 22.02.2016.

Për sa me sipër pala e paditur Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tirane si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier kërkoi nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë, nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungese me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk rezulton që të ketë depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, administroi provat e paraqitura në gjykim çmon se kërkesë padia e paraqitur nga pala paditëse shoqëria "Shametaj Transport" Sh.P.K është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë do të rrëzohet.

Arsyetimi ligjor:

Në nenin 7, pika a të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për; a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontrata administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga organi publik.

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ; Të drejtën e padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Ne nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ; Padia ngrihet;

a) për shfuqizimin teresisht apo pjeserisht të aktit administrativ'.

Rezulton se pala paditëse shoqëria Shametaj sh.p.k nuk ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor, pasi ky akt administrativ është nxjerrë në zbatim të ligjit.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar).

Në nenin 54 të ligjit "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar) parashikohet se "1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.

4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

Në nenin 55 të ligjit "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar) parashikohet se parashikohet se '1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me

para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

2. Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me licencë të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së licencës për këto shoqëri.

3. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.

Ne ligjin 'per transportin rrugor' parashikohet se '3.10.Transport i rregullt udhetaresh eshte sherbim i rregullt transporti ne itinerare dhe vendqendrim te pandryshuara, te ofruara nga transportuesi dhe te percaktuara me pare ne rregulloren e udhetimit. Ky sherbim md te jete qytetes, rrethqytetes, nderqytetes. nderkombetar dhe sherbim i rregullt. i specializuar. .

3..11. Transport i rastit i udhetareve nenkupton sherbimet qe nuk perfshihen ne sherbimet e rregullta brenda vendit ose ato nderkombetare, te perkufizuara ne piken 3.10 te nenit 3, te cilat kryhen ne itinerarin, me cmimin,shkallen e sherbimit dhe kushtet e tjera, qe percaktohen ne marreveshjen ndermjet transportuesit dhe perdoruesit.

Ndersa ne nenin nr. 10 te po ketij ligji percaktohet: ' a) Mbajtesi i licences, pas pageses se cdo udhetari qe perdor kete sherbim. eshte' i detyruar te pajise ate me bilete ose fature si prove e qenies se nje kontrate mes tyre. Te drejtat dhe detyrimet specifike te palevejane percaktuar ne dispozitat e Kodit Civil, b) Tarifat e transportit te udhetareve zbatohen mbi bazen e dispozitave te Itqjit "Per cmimet dhe tarifat".

Ndersa ne nenin nr. 12 te tij pereaktohet: "Transport i udhetareve brenda vendit kryhet nepermjet:a) sherbimeve ne linja te rregullta, transporti qytetes, rrethqytetes dhe nderqytetes:

Ne nenin 19 te ligjit parashikohet se ' Rrjeti i linjave nderqytetese brenda nje qarku dhe oraret e tyre miratohen nga keshilli i qarkut. Licenca per keto linja jepet nga kryetari i bashkise. ku ka seline subjekti transportues.

Ne zbatim te ketij ligji ka dale dhe VKM nr.146 dt.26.02.1998 "Per ndryshimin e tarifave te transportit te udhetimit" ku percaktohet: B) tarifat e transportit rrugore nderqytetas te udhetareve me autobus dhe te transportit id or (liqenor) te jene sipas pereaktimeve ne aneksin 1, qe I hashkelidhet ketij vendimi.

Pra referuar bazes ligjore te mesiperme cmimi i bilatave eshte i paracaktuar ne baze te kilometrave te linjes se licensuar te transportit nderqytetas.

Në neni 122/1/ç i ligjit parashikon kundravajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale,për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave dhe konkretisht :

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

ç) lëshon kupon tatimor, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga

vlera e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

Ndersa ne nenin nr.46 te ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore" si dhe po ne te njejtin nen te UMF nr.24 dt.02.09.2008, percaktohet:"46.1.6 Deftesa tatimore leshohet nga te gjithë personat e tatueshem shites me pakice, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, te cilet nuk jane te pajisur me arke regjistruese ose qe, sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.781 date 14.11.2007, ne raste te vecanta mund te mos leshojne kupon tatimor. Rolin e defteses tatimore mund ta luajne edhe dokumente te tjera te miratuara ne akte te tjera ligjore apo nenligjore ne fuqi, siper shembull biletat e transportit urban, inteurban apo nderkombetar te udhetareve, kuponet e leshuar nga makinal elektronike te fatit, biletat e lojerave te fatit te miratuara nga Mmistrira e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, etj. ".

Ne rastin konkret jemi perpara faktit qe kuponin tatimor e zevendeson bileta dhe per kete arsye kur çmimi i biletës është e ndryshme nga vlera e çmimit te real te paguar nga pasagjeret ,kundravajtesi penalizohet me gjobe ne vleren 30.000 leke.

Rezulton se paditësi në momentin e kontrollit të ushtruar nga pala e paditur ka pajisur pasagjeret me bileta me nje vlere me te ulet se ajo qe realisht pasagjeret kishin ose do te paguanin, fakt i cili vertetohet nga akt-konstatimi date 06.11.2015, ku pasagjeret kane deklaruar se realisht paguanin nje vlere prej 250 leke nderkohe qe bileta qe ishin pajisur pasagjeret kishte vleren 160 leke,dhe për këtë arsye ka shkelur nenin 122/1/ç/i të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar).

Për këtë arsye, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore datë 4060 prot, date 22.02.2016 nxjerre ne baze te procesverbalit te gjobes date 06.11.2015 i DRT Fier eshte nje akt administrative i vlefshem dhe i ligjshem dhe po ashtu dhe vendimi nr.6989/1 date 21.04.2016 i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tiaren qe ka lene ne fuqi kete njoftim vleresimi tatimor eshte i drejte dhe i bazuar ne ligjin "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë " (i ndryshuar) dhe per kete arsye padia e pales paditëse duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale ne shkallë vendi, 30.000(tridhjetë mijë) lekë, për rrjedhojë duke patur parasysh se e drejta e ankimit rregullohet me ligj në këtë rast gjen zbatim neni 45 i ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" , ky vendim është i paankimueshëm.

Sa më sipër gjykata vendos rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pro.civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "**Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin**

e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesë padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
3. Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall sot në Vlorë më datë 24.06.2016

SEKRETARE

Edlira **SHËHU**

GJYQTARE

Gentiana **XHEBILI**

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa e padisë

3.000 (tre mije) leke.

Njoftime

480 (katërqind e tetëdhjetë) leke.

TOTALI

3.480 (tre mije katërqind e tetëdhjetë) leke.

